

**VENDIM**  
**Nr. 11, datë 21.3.2017**

**PËR DETAJIMIN E FONDIT PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT TË  
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, PJESË E FONDIT PËR  
ZHVILLIMIN E RAJONEVE, PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 130, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

**VENDOSI:**

1. Fondi prej 1 935 718 236 (një miliard e nëntëqind e tridhjetë e pesë milionë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, i disponueshëm për financimin e projekteve të reja në vitin 2017, nga programi buxhetor “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, në buxhetin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, alokohet në grante/programme si më poshtë:

a) 1 235 718 236 (një miliard e dyqind e tridhjetë e pesë milionë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, për grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I;

b) 300 000 000 (treqind milionë) lekë, për grantin për inovacionin dhe teknologjinë e komunikimit, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla II;

c) 400 000 000 (katërqind milionë) lekë, për grantin “Nënprogrami i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të), programi i Mbështetjes për Ekonominë, shtylla III.

2. Ngarkohen ministri i Financave, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Edi Rama**

|                                                              |                  |
|--------------------------------------------------------------|------------------|
| Zëvendëskryeministri                                         | Zëvendëskryetar; |
| Ministri i Financave                                         | anëtar;          |
| Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,                    |                  |
| Tregtisë dhe Sipërmarrjes                                    | anëtar           |
| Ministri i Zhvillimit Urban                                  | anëtar;          |
| Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës                   | anëtar;          |
| Ministri i Arsimit dhe Sportit                               | anëtar;          |
| Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe                   |                  |
| Administrimit të Ujërave                                     | anëtar;          |
| Ministri i Shëndetësisë                                      | anëtar;          |
| Ministri i Kulturës                                          | anëtar;          |
| Ministri i Mjedisit                                          | anëtar;          |
| Ministri i Punëve të Brendshme                               | anëtar;          |
| Ministri i Shtetit për Inovacionin                           |                  |
| dhe Administratën Publike                                    | anëtar;          |
| Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore                      | anëtar;          |
| Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë                 | anëtar;          |
| Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /              |                  |
| Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1 | anëtar;          |
| Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /                   |                  |
| Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2 | anëtar;          |
| Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3 | anëtar;          |
| Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4 | anëtar.          |

